



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0006795/24, të datës 24.01.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Blerina Rrahmani nga Podujeva, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.

QSHQ/Arkivit.

znj.Blerina Rrahmani (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/04-0014204/24
Podujevë, datë, 28.02.2024





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-016/01-0012305/24, datë 21.02.2024, nxjerrë këtë;

VENDIM PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU “ SHEFKI LATIFI” NË FSHATIN POLLATË KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z. Enver Halimi, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted] me vendbanim në Podujevë, i kualifikuar Bachelor Teknologji-Informatikë,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të SHFMU “Shefki Latifi” në fshatin Pollatë, Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot. 02-020/02-0043964/22, datë 10.06.2022, për arsye të mbylljes së SHFMU “Sami Frashër” në fshatin Zhiti, si pasojë e mungesës së nxënësve në atë lokalitet.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-016/01-0012305/24
Podujevë, datë: 27.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

Autorizohet z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, derisa znj.Saranda Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga data 26.02.2024 deri më 10.03.2024.

Nr.prot. 02-016/01-0013630/24
Podujevë, datë: 27.02.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja (g) dhe 68 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, nenet 16, 61 paragrafi 1.7 dhe 71 paragrafi 4 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë merr:

V E N D I M MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT-PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE

Neni 1

Vëhen në diskutim publik:

1. Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore, Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 17 ditë përkatësisht prej datës 27.02. 2024 deri më datë 14.03.2024, brenda së cilës Njësiti për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Podujevës mund të organizoj diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse Debati i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më datë 07.03.2024 duke filluar nga ora 13:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 2

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; naime.podvorica@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën në Njësiti për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Podujevës, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 3

Dokumentet sipas nenit 1, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe të njëjtat publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik) dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Njësiti përkatës i vlerëson të nevojshme.

Neni 4

Diskutimi/debati publik zbatohet nga Njësiti për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Podujevës në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raporteve nga diskutimet / debatet publike dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 5


Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

U dërgohet:

Njësitet për të Drejtat e Njeriut.

QSHQ/Arkivit.

Nr.prot 02-016/01-0013625/24
Podujevë, datë, 27.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z. Ismet Kadriu, udhëheqës sektorit të urbanizmit në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit 

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksioni, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr. prot. 02-06/01-0012729/24
Podujevë, datë: 22.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z. Veton Aliu, inxhinier në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mbanë autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit 

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksioni, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:
I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr. prot. 02-016/01-0012734/24
Podujevë, datë: 22.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 14.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 21. 1 të Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nxjerr:

V E N D I M **PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PASURISË JO** **FINANCIARE TË KOMUNËS**

Neni 1

Ngritet Komisioni për vlerësimin e pasurisë jo financiare të Komunës, në përbërje:

Haxhere Ajvazi	kryesuese
Latif Mehmeti	anëtar
Alban Shabani	anëtar
Rrahim Berisha	anëtar
Ardonis Jusufi	anëtar

Mandati i komisionit është dy vite.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren MF- nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni i paraqet raport Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot.02-020/04-0034294/22, datë: 16.05.2022.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0011859/24
Podujevë, datë: 16.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, dhe nenet 14 dhe 19 parag.1.7 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT LOKAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

Neni 1

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale dhe të mirat tjera si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në territorin e Komunës së Podujevës, themelohet komisioni, në këtë përbërje;

Afrim Mulliqi	kryesues
Bleona Musolli,	anëtare
Blerina Zeka,	anëtare
Ardonis Jusufi,	anëtar
Genc Gashi,	anëtar

Neni 2

Komisioni punët dhe detyrat i ushtron në përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe aktet tjera përkatëse nënligjore në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr.prot.02-020/04-0006222/23, datë 23.01.2023, për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

U dërgohet;
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivës

Nr. prot. 02-020/04-0011455/24
Podujevë, datë: 15.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 71 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë merr:

V E N D I M

Neni 1

Emërohet Grupi punues për konsultime publike i caktuar nga organi kompetent i Komunës në këtë përbërje;

Fatlum Osmani, Drejtor i DBF-së	koordinator
Adelina Stublla, Drejtoreshë e DSHMS-së	anëtarë
Avni Fetahu, Drejtor i DKA-së	anëtar
Mimozë Restelica, zyrtare për zhvillim DPZHE	anëtarë
Liridona Rrahmani, zyrtare për informim dhe monitorim të mediave	anëtarë
Valmire Rekalju, zyrtare operatore DSHPMSH	anëtarë
Remzi Kodraliu, zyrtar për regjistrim të adresave DPUMM	anëtar
Imer Hoti, udhëheqës i sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural DBPZHR	anëtar
Arianit Shaqiri, udhëheqës i sektorit të gjendjes civile DA	anëtar

Neni 2

Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projekt-propozimit i cili nënshtrohet procesit të konsultimit publik para aprovimit të tij.

Neni 3

Grupi punues do të punoj sipas Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit.
QSHQ/Arkivit.*

Nr.prot 02-020/04-0011571/24
Podujevë, datë, 15.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.13 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 09-615/03-0005097/24, të datës 17.01.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Xhafer Ademi, nga Podujeva, për organizimin e manifestimit të ditës nacionale të flamurit të komunitetit ashkali mbështetet me mjete financiare në shumë 800.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3


Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorive përkatëse.
QSHQ/Arkivit.
z.Xhafer Ademi (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot 02-020/04-0011165/24
Podujevë, datë, 14.02.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, jep;

AUTORIZIM

Autorizohet z.Faik Rama, nr. personal i letërnjoftimit [redacted] nr. i kartelës identifikuese zyrtare KPO 0071, përfaqësues i Komunës për konteste juridike, të përfaqësojë Komunën e Podujevës në procedura gjyqësore në të gjitha gjykatat, në të gjitha lëndët, përkatësisht çështjet juridike në të cilat Komuna është në cilësinë e paditëses ose të paditurës dhe lidhur me këtë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike.

Autorizimi vlen deri më 31.12. 2024.

Nr.prot. 02-016/09-0011167124
Podujevë, datë: 14.02.2024



Kryetari i Komunës
Shefqim Buliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0010272/24, të datës 09.02.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Ilirjana Konushevc nga fshati Llugë, Komuna e Podujevës, për trajtimin mjekësor të babait të saj Ilmi Kunushevc, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

Neni 3


Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.
QSHQ/Arkivit.
znj.Ilirjana Konushevc (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/04-0010710/24
Podujevë, datë, 12.02.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.13 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 09-615/03-0003071/24, të datës 10.01.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Kushtrim Ajeti, nga fshati Sallabajë Komuna e Podujevës, për koordinimin e aktiviteteve të muzikës klasike në kuadër të koncertit të mbajtur në fund të vitit 2023, mbështetet me mjete financiare në shumë 300.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Kushtrim Ajeti (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot 02-400/04-0010724/24
Podujevë, datë, 12.02.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.13 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 09-615/03-0002858/24, të datës 10.01.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Ardonat Blakçori, nga Podujeva, për organizimin e koncertit të mbajtur në fund të vitit 2023, mbështetet me mjete financiare në shumë 300.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:


Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Ardonat Blakçori (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot 02-400/04-0010727/24
Podujevë, datë, 12.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Ligjit nr. 08/L-114 për Regjistrimin e Popullsisë Ekonomive Familjare dhe Banesave, nenit 3 të Rregullores për Funkcionimin e Komisionit Komunal për Rexhistrim nr. 01-01-2023 dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. PROT. 02-020/04-0006218/23 DATË 23.01.2023

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot. 02-020/04-0006218/23 datë 23.01.2023 për regjistrimin e popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në territorin e Komunës së Podujevës, dhe atë:

Në vend të znj.Antoneta Ejupi, në cilësinë e anëtares së Komisionit caktohet znj.Xhevrie Beqiri Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës

Në vend të z.Genc Rashiti, në cilësinë e anëtarit të Komisionit caktohet z. Shqipdon Rushiti, nga shoqëria civile

Në vend të z.Fatmir Rudari, në cilësinë e anëtarit të Komisionit caktohet znj.Lirie Hoti, Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Në vend të znj.Saranda Stublla në cilësinë e anëtarit të Komisionit caktohet z.Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 2

Zëvendësimet sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhen për arsye të ndryshimeve në Ekzekutivin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr. prot 02-020/04-0006218/23 datë 23.01.2023 për regjistrimin e popullsisë ekonomive familjare dhe banesave në territorin e Komunës së Podujevës

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
ASK-së
QSHQ/ Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0010455/24
Podujevë, datë: 09.02.2024

Kryetari i Komunës
Shqiprim Balliqi



KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 14 të Ligji nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit për Performancë Komunale dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, nxjerr;

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT PËR PERFORMANCË SI DHE ZYRTARËVE RAPORTUES PËR FUSHAT E PERFORMANCËS NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për Sistemin e Menaxhimit të Performancës në Komunën e Podujevës, caktohet koordinatori dhe zyrtarët raportues për fushat e performancës, në këtë përbërje:

1. Ejup Babatinca, koordinator
2. Halit Vërshefci, në fushën - Kujdesi primar shëndetësor, anëtare
3. Liridona Rrahmani, në fushën - Transparenca komunale, anëtare
4. Enis Sheholli, në fushën - Përgjegjshmëria komunale, anëtar
5. Arianit Shaqiri, në fushën - Shërbimet publike administrative, anëtar
6. Arbëresha Bashota, në fushën - Barazia në punësim; Përfaqësimi gjinor, anëtare
7. Arbër Sfishta, në fushën - Kulturë, rini dhe sport, anëtar
8. Kujtim Zhitia, në fushën - Menaxhimi i fatkeqësive, anëtar
9. Florie Mani, në fushën - Planifikimi hapësinor, anëtare
10. Remzi Kodraliu, në fushën - Hapësirat publike; Menaxhimi i mbeturinave; Mbrojtja e ambientit, anëtar
11. Flaka Ademi, në fushën - Infrastruktura rrugore, anëtare
11. Egzona Rama, në fushën -Transporti publik; Parkingjet publike, anëtare
12. Mahmut Ajvazi, në fushën - Uji i pijshëm, anëtare
13. Afrim Mulliqi, në fushën - Kanalizimi, anëtar
14. Ardian Emini, në fushën - Arsimiti parauniversitar, anëtar
15. Genc Gashi, në fushën - Zhvillimi ekonomik lokal, anëtar

Koordinatori dhe zyrtarët janë përgjegjës sipas fushave të përcaktuara sipas këtij vendimi.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinators dhe zyrtarëve janë të përcaktuara në rregullativën ligjore në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot. 02-020/04-0027964/23, datë 20.04.2023 për emërimin e koordinators dhe zyrtarëve për administrimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës në Komunën e Podujevës dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit bazë nr. prot. 02-020/05-0047004/23, datë 11.07.2023.

U dërgohet;
Të caktuarve
QSHQ/Arkiv

Nr.prot. 02-016/09-0009835/24
Podujevë, datë: 08.02.2024



Kryetari i Komunës
Shujtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të datës 23 shkurt 2023, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës publike nr.prot.15-300/01-003013/24 të datës 10.01.2024, për aplikim në projektin, Ngritja dhe Zhvillimi i Bizneseve, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

Shkurte Musa , zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillim Ekonomik,	kryesuese
Alban Shabani , zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave,	anëtar
Emine Muçolli , zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillim Ekonomik,	anëtare

Neni 2

Komisioni sipas këtij vendimi, punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren komunale nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022 për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
QSHQ/Arkivit

Nr.Prot. 02-020/04-0009833/24
Podujevë, datë, 08.02.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi